



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E QYTETIT
KORÇË

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Drejtoria e Prokurimeve

Date 08.11.2016

Nr ____ Prot

Date 08.11.2016

Nga: *Bashkia Korçë, rruga "28 Nentori", 082 243353.*

Për: *Shoqeria "TTE. GRUP" sh.p.k, adresa: Tiranë, Rruga dytësore, Autostrada Tiranë – Durrës, km 5*

Procedura e prokurimit: *Kërkesë për propozim*



Objekti: *"Ndriçimi me llampa 70 W CMH"*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Kjo kontrate ka per qellim furnizimin me llampa ndriçimi 70w CMH*

Fondi limit: **11.310.720 leke**

Burimi i financimit: *Te ardhurat e Bashkise Korce*

Shpenzim operativ

Data e zhvillimit te procedures se prokurimit: **10.10.2016**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri] -

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: *çmimi më i ulët*

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. Personi fizik "Vaske Gaqi ", NIPT K33729014R me vleren:

8,115.000 (tete milion e njeqind e pesembedhete mije)lek

2. Shoqeria "I T E. GRUP" sh.p.k, NIPT K11323001H me vleren:
9,797,200 (nente milion e shtateqind e nentedhjete e shtate mije e dyqind)lek
3. Shoqeria "Vasaa", NIPT J62903470T me vleren:
10,016,900 (dhjete milion e gjashtembedhjete mije e nenteqind)lek
4. Shoqeria "Boshnjaku B" sh.p.k, NIPT K72627402H me vleren:
10,134,160 (dhjete milion e njeqind e tridhjete e kater mije e njeqind e gjashtedhjete)lek
5. Shoqeria "Hest" sh.p.k, NIPT L21527009H me vleren:
10,279,800 (dhjete milion e dyqind e shtatedhjete e nente mije e teteqind)lek
6. Shoqeria "Elal Com" sh.p.k, NIPT K72418010P me vleren:
11,021,900 (njembedhjete milion e njezet e nje mije e nenteqind)lek

* * *

Jane s'kualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. Personi fizik "Vaske Gaqi ", per arsye se:

-Ndricuesi rrugor 70W

- Kasa e ndricuesit ka mbulesen e sipërme prej alumini dhe pjesen e kapakut te poshtem plastik.
- Nuk ka te dhena per shkallen e mbrojtjes mekanike (IK 09)

-Llamba 70W CMH E27

- Fluksi i llampes eshte 7150 lm nga 7300 lm e kerkuar nga ana jone
- Jetegjatesia eshte 20.000 ore pune nga 24.000 ore pune e kerkuar nga ana jone.

-Automatet 4P dhe 1P

- Nuk ka paraqitur skede teknike per automatet.

-Kontaktor

- Nuk ka paraqitur skede teknike per kontaktoret.

-Sensor ndricimi

- Nuk ka paraqitur skede teknike per sensorin e ndricimit.

Të gjitha këto në kundërshtim me kriteret e vendosura në DT, shtojca 8, kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.a ku percaktohet shprehimisht : "Skedat teknike per te gjithë produktet te permendura ne specifikimet teknike, te cilat duhet te perputhen me pershkrimin e bere ne specifikimet teknike."

2. Shoqeria "Vasaa" sh.p.k, per arsye se:

Ndricuesi rrugor 70W

- Nuk ka te dhena per shkallen e mbrojtjes mekanike (IK 09)

- Te gjitha skedat teknike te paraqitura nuk jane te perkthyer dhe te noterizuara

Këto në kundërshtim me kriteret e vendosura në DT, shtojca 8, kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.a ku percaktohet shprehimisht : “Skedat teknike per te gjithë produktet te permendura ne specifikimet teknike, te cilat duhet te perputhen me pershkrimin e bere ne specifikimet teknike.”

3. Shoqeria “Boshnjaku B” sh.p.k, per arsye se:

1.Në lidhje me furnizimet e ngjashme ky operator ka paraqitur kontrata furnizimi me subjekte private por nuk ka paraqitur faturat tatimore të shitjeve. Tek furnizimi me entet publike konkretisht me Bashkinë Lushnjë subjekti ka paraqitur kontratën për blerje pllakash trotuari dhe shtrim trotuari, aktin e dorëzimit dhe nga kontrata dhe faturat tatimore rezulton se materialet objekt i kontratës janë materiale ndërtimi si: zhavor stabilizant etj. Kjo bie në kundërshtim me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit ku tek kapaciteti teknik kërkohet: **Kapaciteti Teknik: Furnizime të ngjashme me vlere 40% te fondit limit të realizuara gjatë tre viteve të fundit.** *Ne rast te pervojës te meparshme te realizuar me ente publike duhet te paraqitet kontrata shoqeruar me vertetimin per realizimin e sukseshem te kontrates ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara. Ne rast te pervojës te meparshme te realizuar me sektorin privat duhet te paraqiten fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.*

2. Nuk jane paraqitur mostra të materialeve në kundërshtim me kriteret e vendosura në DT kapaciteti teknik ku shprehimisht kërkohet: Operatori duhet te paraqese mostra te materialeve:

Ndricues e 27 70 W CMH dhe Llambe CMH 70 W E 27. **Mostrat duhet te dorezohen me nje shkrese percjellese ne Bashkine Korce,ne zyren e protokoll-arkivit,brenda dates 03.10.2016 ora 11:00. Mos dorezimi i mostrave brenda ketij afati do te sjelle s’kualifikimin e operatorit pjesemarres.”**

4. Shoqeria “Hest” sh.p.k, per arsye se:

1.Në lidhje me furnizimet e ngjashme ky operator ka paraqitur kontrata furnizimi me subjekte private por vlere e shumës së faturave tatimore të shitjeve është më e vogël se 40% e fondit limit. Tek furnizimi me entet publike konkretisht me NSHP, Bashkia Korçë, operatori juaj ka paraqitur kontratën me objekt furnizimin me materiale elektrike, lidhur në datën 27.08.2016 dhe vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës . Data kur është lidhur kjo kontratë është më shumë se para tre vjetësh referuar datës së tenderit dhe nga dokumentet e paraqitura nuk evitohet se kur është data e përfundimit të kontratës prandaj data e lidhjes do të jetë data e vetme së cilës do i referohemi. Kjo bie në kundërshtim me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit ku tek kapaciteti teknik kërkohet: **Kapaciteti Teknik: Furnizime të ngjashme me vlere 40% te fondit limit të realizuara gjatë tre viteve të fundit.** *Ne rast te pervojës te meparshme te realizuar me ente publike duhet te paraqitet kontrata shoqeruar me vertetimin per realizimin e sukseshem te kontrates ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara. Ne rast te pervojës te meparshme te realizuar me sektorin privat duhet te paraqiten fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.*

2. Nuk jane paraqitur mostra të materialeve në kundërshtim me kriteret e vendosura në DT **kapaciteti teknik**, ku shprehimisht kërkohet: Operatori duhet te paraqese mostra te materialeve:

Ndricues e 27 70 W CMH dhe Llambe CMH 70 W E 27 **Mostrat duhet te dorezohen me nje shkrese percjellese ne Bashkine Korce,ne zyren e protokoll-arkivit,brenda dates 03.10.2016 ora 11:00. Mos dorezimi i mostrave brenda ketij afati do te sjelle s’kualifikimin e operatorit pjesemarres.”**

3. Mungon certifikata e gjendjes financiare në kundërshtim me DT ku shprehimisht kërkohet : **Kapaciteti ekonomik:** Një certifikatë të gjendjes financiare nga një ose më shumë banka me vlere **një vlerë sa 10% e vleres te fondit limit e leshuar jo me pare se data 28.09.2016**

5. *Shoqeria “Elal Com” sh.p.k, per arsye se:*

1. Nuk jane paraqitur mostra të materialeve në kundërshtim me kriteret e vendosura në DT **kapaciteti teknik** ku shprehimisht kërkohet: Operatori duhet te paraqese mostra te materialeve:

Ndricues e 27 70 W CMH dhe Llampe CMH 70 W E 27 **Mostrat duhet te dorezohen me nje shkrese percjellese ne Bashkine Korce,ne zyren e protokoll-arkivit,brenda dates 03.10.2016 ora 11:00. Mos dorezimi i mostrave brenda ketij afati do te sjelle s’kualifikimin e operatorit pjesemarres.”**

2. Mungon certifikata e gjendjes financiare në kundërshtim me DT ku shprehimisht kërkohet : **Kapaciteti ekonomik:** Një certifikatë të gjendjes financiare nga një ose më shumë banka me vlere **një vlerë sa 10% e vleres te fondit limit e leshuar jo me pare se data 28.09.2016**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *Shoqeria “ITE.GRUP ”, adresa Tirane, Rruga dytesore, Tirane –Durrës, km 5*, se oferta e paraqitur me një vlerë prej **9,797,200 (nente milion e shtateqind e nentedhete e shtate mije e dyqind)lek pa tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesëshme.

* * *

Rrjedhimisht jeni te lutur, të paraqisni pranë **Bashkise Korçë**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të së këtij njoftimi, por jo me vonë se 5 dite nga kërkesa e per lidhjen e kontrates.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 18.10.2016

Ankesa PO

Subjekti fizik Vaske Gaqi,

Formulari i ankeses date 20.10.2016 me Nr. 2481 Prot.

Kthim pergjigje date 27.10.2016 me Nr.2481/1 Prot

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**